



Udhërrëfyes i lehtë për tu lexuar për të plotësuar
formularin e aplikimit për
Programin e Strehimit Social

Prill 2022






Për çfarë flet ky udhërrëfyes?

Ky udhërrëfyes do t'ju ndihmojë të plotësoni aplikimin tuaj pranë autoriteteve lokale për programin e strehimit social.

Ju mund të keni nevojë për dikë të besuar që t'ju ndihmojë të plotësoni aplikimin.

Aplikimi për programin e strehimit social ka shumë informacione dhe dokumente.

Ju mund ta tërhiqni formularin e aplikimit për programin e strehimit social pranë autoritetit lokal ku jetoni.



Kush mund të përfitojë nga programi i strehimit social?

Ju mund të përfitoni nga programi i strehimit social nëse nuk keni mjaftueshëm para për të paguar për një banesë të tuajën.



Ku mund ta merrni shërbimin e programit të strehimit social?

Ju mund ta merrni shërbimin e programi të strehimit social nga autoriteti lokal (këshilli i qytetit ose i kontesë) ose një agjenci tjetër që quhet Organ Strehimi i Aprovuar.

Një Organ Strehimi i Aprovuar është një organizatë që mund të ofrojë strehim për grupe njerëzish, për shembull Clúid dhe The Simon Community.



Shërbimi i aftësisë së kufizuar me të cilin jeni lidhur mund të jetë një Organ Strehimi i Aprovuar.

Llojet e programit të strehimit social



Disa lloje programesh që mund të merrni nga autoriteti lokal janë si më poshtë:

Mund të merrni me qira shtëpi ose apartamente nga autoriteti lokal ose një Organ Strehimi i Aprovuar.



Mund të merrni me qira një shtëpi ose një apartament nëpërmjet skemave të tilla si Skema e Akomodimit me Qira (SAQ) Skema për Pagesën e Ndhmës për Strehim (PNS).

Njerëzit e moshuar, të pastrehët, udhëtarët dhe njerëzit me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë nga ndihma për strehim.



Nëse ju duhet ndihmë për të plotësuar formularin e aplikimit, mund të kontaktoni me Departamentin e Strehimit pranë autoritetit tuaj lokal ose me një Qendër Informacioni për Qytetarët.



Gjithashtu, mund t'ju ndihmojë një person i besuar për të plotësuar formularin.

Informacion i rëndësishëm për të plotësuar formularin.



Shkruajini qartë përgjigjet.

Është e rëndësishme që ti përgjigjeni të gjitha pyetjeve që përmban formulari i aplikimit.

Aplikimi juaj nuk do të avancojë nëse nuk plotësoni të gjithë informacionin që kemi nevojë.

N/A

Duhet të shkruani N/A nëse pyetja nuk lidhet me ju.

Sigurohuni që të nënshkruani kudo ku ju kërkohet të nënshkruani.



Autoriteti juaj lokal do të sigurohet që të zbatoni rregullat e të drejtave GDPR (Rregullore e përgjithshme e mbrojtjes së të dhënave) dhe informacionin tuaj.

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër në lidhje me këtë, pyesni autoritetin tuaj lokal.



Ju duhet të dërgoni edhe dokumente të tjera së bashku me formularin. Keni një listë kontrolli që do t'ju ndihmojë të kujtoheni për të gjitha.

Aplikimi juaj nuk do të avancojë nëse nuk i dërgoni të gjitha sa kërkohet.




Autoriteti lokal mund t'ju kërkojë më tepër informacion në vijim.

Nëse të dhënat tuaja ndryshojnë (për shembull, nëse martoheni ose transferoheni në një shtëpi të re), duhet të njoftoni autoritetin lokal.



Është shumë e rëndësishme që ti përgjigjeni letrave dhe e-mail-eve të autoritetit lokal.

Nëse nuk i përgjigjeni të gjitha letrave dhe e-mail-eve, autoriteti lokal mund t'ju heq nga lista e pritjes. Kjo nënkupton që nuk do të përfitoni programin e strehimit social.



Ju mund të zgjidhni dikë të afërt për t'ju ndihmuar ti përgjigjeni letrave dhe e-mail-eve të autoritetit lokal.

Ata quhen bashkë-korrespondent.



Autoriteti lokal do të njoftojë bashkë-korrespondentin tuaj kur ju dërgojnë një letër ose e-mail.

Ju lutemi të mbani një kopje të çdo dokumenti përpara se ti dërgoni te autoriteti lokal.

Lista e kontrollit



Formulari ka një listë kontrolli, ku përfshihet i gjithë informacioni shtesë dhe dokumentet që duhet ti dërgoni së bashku me formularin e aplikimit tuaj.

Mos harroni që ti përgjigjeni të gjitha pyetjeve të formularit, sepse në të kundërt aplikimi juaj nuk do të avancojë.

Mundohuni ta dorëzoni personalisht formularin pranë zyrës së autoritetit lokal në mënyrë që ata të sigurohen se i jeni përgjigjur të gjitha pyetjeve të nevojshme.

Ata mund t'ju ndihmojnë gjithashtu të siguroheni që i keni të gjithë dokumentet e tjera të nevojshme për aplikimin tuaj.

Do ti përshkruajmë dhe shpjegojmë informacionin dhe dokumentet shtesë që ju duhen si më poshtë:



Informacion personal

- Dokument identifikimi me foto (pasaportë ose leje drejtimi).
- Certifikata lindjeje (për ju dhe për çdo person që po aplikon me ju, si p.sh partneri/ja).
- Numrat PPS, *numër personal për shërbimet publike*, (për ju dhe çdo person tjetër që po aplikon me ju).
- Vërtetim adrese (p.sh fatura e energjisë elektrike).

METER NO.	METER READINGS	ELECTRICITY USED	METER READING TYPES
Z000001234	6010 5065	945	ⓐ Actual reading ⓑ Customer reading

Informacion për të ardhurat (i vazhduar)

Të ardhura nga ndihma sociale

- Nëse ju (dhe ndonjë nga personat që po aplikon me ju) merrni pagesa nga ndihma sociale, duhet të dërgoni informacion dhe vërtetim për këtë. Mund të merrni një vërtetim nga Departamenti i Mbrojtjes Sociale.
- Ky vërtetim do të pasqyrojë paratë që merrni prej tyre.



I/e vetë punësuar

- Nëse jeni të vetë punësuar, do t'ju duhen të paktën llogaritë për 2 vjet, të shoqëruara me raportin e një audituesi dhe një njoftim vlerësimi dhe/ose një deklaratë njohjeje për vetë vlerësimin (për 12 muajt e fundit).

Pensionet

- Nëse jeni anëtar i një skeme pensioni të shërbimeve publike, ose keni atë që quhet Kontribut shtesë mbi pensionet (ASC), atëherë duhet të paraqitni gjithashtu
 - listë pagesën përfundimtare nga viti i fundit, dhe
 - listëpagesën më të fundit të këtij viti

Payment No.	Employee Name	Payment Date	Payment Amount	Payment Type	Payment Status
0834	FULL NAME HERE	201012005	NP0000008		
Earnings		Units	Rate	Amount	Amount
Gross Salary		1.00	3750.00	3750.00	
Monthly					
Payment Method:					
Cheque					
Deductions					
PAYE Tax				845.19	
National Insurance				265.62	
FULL NAME		Tax Period: 10		Tax Code: 489L	
35 ANYWHERE COURT		Total Gross Pay		3750.00	
KENSINGTON		Gross for Tax		3750.00	
SW3 0DD		Earnings for NI		2730.00	
COMPANY NAME		Total Gross Pay TD		3750.00	
		Gross for Tax TD		3750.00	
		Tax Paid TD		845.19	
		Earnings for NI TD		2730.00	
		National Insurance TD		265.62	
		Net Pay		2639.19	

Informacion shtesë që mund t'ju përkas juve (nëse nuk ju përket, mund të shkruani N/A)



- Informacion dhe vërtetim të shtetësisë ose të leje qëndrimit në Irlandë për ju dhe çdo person tjetër që po aplikon me ju.

(p.sh një letër nga Departamenti i Drejtësisë).

- Certifikata e martesës.

- Kopje e marrëveshjes së ndarjes / divorcit.


- Informacion dhe vërtetim të marrëveshjes së qiramarrjes dhe regjistrimin nga Bordi i Qiramarrjes Rezidenciale nëse jeni aktualisht me qira.

- Informacion për pronën ose tokën që zotëroni ju (ose çdo person që po aplikon me ju).

Informacioni duhet të përfshijë vendndodhjen, vlerën, statusin e pronës dhe çdo të ardhur që merrni prej saj.




- Nëse zotëroni një shtëpi dhe jeni në vështirësi me pagesat për hipotekën, ju duhet një letër nga njësia e mbështetjes së detyrimeve të prapambetura të huadhënësit tuaj.



- Një letër nga autoriteti lokal ose nga Organi i Strehimit i Aprovuar ku keni jetuar më parë nëse keni qenë pjesë e programit të strehimit social.

- Informacion dhe vërtetim me një lidhje me zonën tuaj lokale nëse nuk jetoni më atje, p.sh, kjo mund të jetë provë që ju keni jetuar aty më parë.



- Një formular të plotësuar me informacion për aftësitë e kufizuara dhe/ose nevojën mjekësore. Mund ta merrni këtë formular nga autoriteti juaj lokal. Më tepër informacion mund ta gjeni në faqen 18.



- Një raport nga Terapisti Profesional (TA) për çfarë mund t'ju duhet në shtëpi, të tilla si pajisje ose ndryshime në shtëpi për ta bërë atë më të aksesueshme për ju.

Ky formular përbëhet nga 12 pjesë dhe ky është një udhërrëfyes i këtyre pjesëve



Pjesa 1: Rreth jush (Të dhëna personale)

- Kjo pjesë ju kërkon informacione të tilla si emrin tuaj, datën e lindjes, adresën aktuale, etj.
- Nëse po aplikon dhe dikush tjetër me ju për strehimin social (p.sh partneri/ja), atëherë ata duhet të plotësojnë gjithashtu të dhënat e tyre personale.



Pjesa 2: Nga jeni (Detaje mbi shtetësinë)

- Kjo pjesë ju kërkon informacion për vendin e lindjes, për gjuhën që flisni, statusin e shtetësisë suaj, p.sh nëse jeni Irlandez.

Pjesa 3: Ku punoni (Detaje mbi punësimin)

- Kjo pjesë ju kërkon informacion nëse jeni në punë.
- Kërkon informacion për detajet e punëdhënësit tuaj, të tilla si emri dhe adresa e kompanisë.



Pjesa 4: Çfarë parash fitoni (Të dhëna mbi të ardhurat)

- Duhet të deklaroni të ardhurat ose pagat tuaja javore përpara se të jenë paguar taksat (paga bruto). Këto mund të jenë paratë që merrni nga puna, ndihma sociale ose çdo para tjetër që fitoni.
- Më pas duhet të bëni një listë se çfarë është hequr nga paratë tuaja (zbritjet), mund të jenë të tilla si Paguani sa fitoni (PAYE), Sigurimet shoqërore të lidhura me pagesën (PRSI).

Employer No.	Employment Method	Pay Period	Payment Date	Employer Reference	
0834	FULL NAME HERE	20/01/2005		NP0000009	
Payments	Units	Rate	Amount	Details	Amount
Gross Salary	1.00	3750.00	3750.00	PAYE Tax	845.19
Monthly				National Insurance	265.62
Payment Method:					
Cheque					
FULL NAME 35 ANYWHERE COURT KENSINGTON SW3 0DD		Tax Period: 10 Total Gross Pay Gross for Tax Earnings for NI	Tax Code: 489L 3750.00 3750.00 2750.00	Total Gross Pay TD Gross for Tax TD Tax Paid TD Earnings for NI TD National Insurance TD	37500.00 37500.00 8451.90 27500.00 2656.20
COMPANY NAME		Net Pay		2639.19	

Pjesa 5: Persona të tjerë që aplikojnë me ju (Anëtarë të tjerë të familjes)



- Kjo pjesë kërkon informacion për njerëzit e tjerë që do të jetojnë me ju në të njëjtën shtëpi. Për shembull, partneri ose fëmijët tuaj.
- Duhet të jepni detaje për emrat e tyre, datën e lindjes, vendin e lindjes, statusin e shtetësisë, gjininë, gjendjen civile.

Pjesa 6: Ku jetoni tani (Akomodimi aktual)



- Kjo pjesë kërkon informacion për vendin ku jetoni aktualisht dhe detajet përkatëse.
- Kërkon informacion nëse e zotëroni ose e keni marr me qira shtëpinë ku jetoni dhe për llojin e banesës.
- Nëse e keni marr me qira, duhet të jepni informacione dhe ta vërtetoni.
- Kërkon informacion për arsyen që po kërkonti mbështetje (si p.sh aftësi të kufizuara).
- Më pas duhet të shpjegoni se çfarë ka në shtëpinë aktuale ku jetoni.

Pjesa 7: Ku keni jetuar më parë (Historiku i akomodimit)



- Kjo pjesë ju kërkon të jepni informacion se ku keni jetuar 5 vite më parë.

Pjesa 8: Për çfarë shtëpie keni nevojë (Kërkesat për akomodim)



- Ky seksion ju kërkon të identifikoheni si një Irish Traveller.

Kjo është për të kuptuar nëse jeni një Udhëtar dhe do të dëshronit të përfshiheshit në Programet e Strehimit të Udhëtarëve.



Kjo i jep autoriteve lokale informacionin për të cilin kanë nevojë që të përmirësojnë Programet e tyre të Strehimit të Udhëtarëve.

Ky informacion nuk do të ndikojë nëse një person ka të drejtën e përfitimit të strehimit social.



- Kjo pjesë kërkon gjithashtu informacion për nevojat tuaja të strehimit për ta bërë shtëpinë tuaj më të aksesueshme. P.sh, të ndryshohet tualeti, dhoma e gjumit ose të vendosen rampa.



- Nëse po aplikoni bazuar në nevoja mjekësore ose aftësi të kufizuara, do t`ju kërkohet të jepni detaje mbi nevojat tuaja.
- Nëse po aplikoni bazuar në nevoja mjekësore ose aftësi të kufizuara, do t`ju duhet të plotësoni edhe një formular tjetër, formularin Informacione mbi aftësitë e kufizuara dhe/ose nevojat mjekësore.


Këtë mund ta merrni nga autoriteti juaj lokal. Më tepër informacion mund të gjeni në këtë formular në faqen 18.



Pjesa 9: Bazat për aplikim

- Mund të aplikoni vetëm në një autoritet lokal për programin e strehimit.
- Emri i autoritetit lokal se ku do të dëshironit të jetonit gjendet në fillim të formularit të aplikimit.
- Autoriteti lokal duhet të jetë në zonën në cilën jetoni.
- Do t`ju kërkohet të zgjidhni se ku do të dëshironit të jetonit në këtë autoritet lokal.





- Ju duhet ti zgjidhni me kujdes këto zona, mendoni për shërbime të tilla si transporti, largësinë me familjen dhe miqtë dhe llojin e strehimit në zonën që po zgjidhni.



- Mund të aplikoni në një zonë tjetër nëse dikush që jeton në shtëpi ka një lidhje lokale me këtë zonë.

- Një lidhje lokale është kur dikush:

- ka jetuar në një zonë për 5 vite,

- punon brenda një distance prej 15km brenda zonës,

- shkon aty në shkollë ose kolegji,

- ka nevoja shërbimi arsimor ose mjekësor në atë zonë,

- ka një të afërt që jeton në zonë për më shumë se 2 vite. I afërt përfshin një prind, fëmijë madhor ose motër/vëlla. Mund të përfshijë edhe një të afërt tjetër që ka lidhje të afërt me anëtarin e familjes.



Pjesa 10: Shtëpi të tjera që zotëroni (Informacione të tjera mbi pronën)



- Kjo pjesë ju kërkon informacion për ndonjë pronë ose tokë që mund të zotëroni.
- Kërkon informacion për ndonjë pronë ose tokë që mund ta zotërojë dikush që po aplikon me ju.
- Vendosni n/a në kutitë nëse këto pyetje nuk janë të vlefshme për ju.

N/A



Pjesa 11: Kundërvajtjet e rendit publik dhe informacione të tjera

- Kjo pjesë kërkon informacion nëse keni pasur ndonjëherë probleme me Gardain.

Pjesa 12: Informacione të tjera

- Shtoni çdo gjë tjetër që mund të jetë e rëndësishme ose e nevojshme për t`ju ndihmuar në aplikimin tuaj.



Deklarata



Në fund të formularit të aplikimit gjendet një seksion që duhet ta nënshkruani, quhet "Deklarata".


Lexojeni me kujdes deklaratën dhe nënshkruajeni. Nëse po aplikon dhe dikush tjetër me ju, duhet ta firmosin edhe ata.



Nëse ju nevojitet ndihmë për ta plotësuar këtë formular mund të kontaktoni me Departamentin e Strehimit pranë autoritetit tuaj lokal ose në një Qendër Informacioni për Qytetarët dhe ata do t`ju ndihmojnë. Mund t`ju ndihmojë gjithashtu një person i besuar për ju.

Formular me informacione për aftësitë e kufizuara / nevojat mjekësore

Për çfarë flet ky formular?



Nëse po aplikoni në programin e strehimit social sepse keni aftësi të kufizuara, duhet të plotësoni një formular tjetër.

Ky formular quhet HMD – Formulari 1. Këtë formular mund t'ia kërkoni autoritetit tuaj lokal.

Informacion i rëndësishëm

Mund të përfitoni statusin prioritar nëse keni aftësi të kufizuara ose nevoja mjekësore.

Kjo do të jetë në varësi të situatës suaj të strehimit.

Formulari ka katër seksione. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin 1 dhe 2.


Dy profesionistë të kujdesit shëndetësor do të plotësojnë për ju seksionin 3 dhe 4.

Një profesionist i kujdesit shëndetësor përfshin profesionet e mëposhtme: Konsulent, mjek i përgjithshëm (MP), infermiere e shëndetit mendor, terapist profesionist ose punonjës social.

Mund t'ju duhet raporti i një terapisti profesionist (TP) në varësi të nevojave tuaja të strehimit, nëse do të dëshironit të ndryshonit shtëpinë për ta bërë më të aksesueshme për veten tuaj.



Ky formular ka 4 seksione dhe ky është një udhërrëfyes për këto seksione



Seksioni 1: Informacion për aftësitë e kufizuara dhe/ose nevoja mjekësore

- Ky seksion ju kërkon të plotësoni informacionin për aftësitë tuaja të kufizuara dhe/ose nevojat mjekësore.

Seksioni 2: Rreth jush (Të dhëna personale)



- Ky seksion ju kërkon të jepni informacione për veten tuaj, p.sh: emrin tuaj dhe datën e lindjes.

Seksioni 3A: Detajet e profesionistit të kujdesit shëndetësor



- Të dy profesionistët e kujdesit shëndetësor plotësojnë detajet e tyre të kontaktit në këtë seksion.
- Ata plotësojnë disa nga pjesët e formularit për të mbështetur aplikimin tuaj.



Seksioni 3B: Detajet e akomodimit aktual

- Ky seksion pyet profesionistët e kujdesit shëndetësor për vendin ku jetoni aktualisht dhe nëse ndikon për keq te ju.



Seksioni 3C: Detajet e akomodimit

- Ky seksion pyet profesionistët e kujdesit shëndetësor se si një ndryshim në vendin ku jetoni do të ishte një gjë e mirë për ju.



Seksioni 3D: Nevojat për mbështetje

- Këtu pyeten profesionistët e kujdesit shëndetësor për ndihmat që ju duhen për të jetuar në mënyrë të pavarur.

Seksioni 4: Deklarata e porfesionistëve të shëndetit profesional



- Të dy profesionistët e kujdesit shëndetësor e nënshkruajnë dhe i vendosin datën formularit.